



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ARJ nr. 24/2024

Gjykata Supreme në Prishtinë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ragip Namani, kryetar, Nebojša Borčić dhe Zenel Leku anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ të paditësit, “G T.. AF “., me seli në F.K., sipas autorizimit e përfaqëson, Albana Kelmendi avokate me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, (DK), në P., me bazë juridike, anulimi i vendimit të organit të paditur, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruar nga paditësi për mes përfaqësueses si më lartë, kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, e Republikës së Kosovës, nr. K. DH. SH. II. 516/22, të datës 04.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 21 Mars 2024, merr;

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pabazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi, “G. T. AF “., me seli në F.K., kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, nr. K. DH. SH. II. 516/22, të datës 04.05.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale, Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit e datës 17.05.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative- Divizioni Fiskal, A. nr. 2000/19, i datës 10.03. 2021, Vërtetohet.

Paditësi për mes përfaqësueses av. Albana Kelmendi në afat ligjor në Gjykatë Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, më të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të shkallës së dytë për shkak të; shkeljes së dispozitave procedurale, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim, të aprovohet kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të ndryshohen, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative- Divizioni Fiskal, A. nr. 2000/19, i datës 10.03.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, nr. K. DH. SH. II. 516/22, të datës 05.05.2023, dhe të aprovoj padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ose ti anuloj aktgjykimet e cekura më lartë dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të kontestuar, sipas pretendimeve nga kërkesa e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, dhe shqyrtimit edhe të akteve tjera lëndës, gjen se;

Kërkesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale-dhoma e shkallës së dytë, Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit e datës 17.05.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative- Divizioni Fiskal, A. nr. 2000/19, i datës 10.03. 2021, Vërtetohet, sipas të cilit, refuzohet si e pa bazuar kërkesë padia e paditësit, G.T. A.F., sh.p.k., nga F.K., si e pa bazuar, ndërsa mbetet në fuqi aktvendimi i Doganës së Kosovës në P., nr.07.3/ 147/2016, i datës 18.07.2019.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, Gjykata Supreme, pas ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar, vlerësimit të pretendimeve në kërkesë dhe shqyrtimit të akteve të tjera të lëndës gjen se, gjykata e shkallës së dytë ka vendosur drejtë me refuzimin si të pabazuar të ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, meqë aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë me shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, ashtu si pretendon paditësi në kërkesën e tij.

Në bazë të dëshmive në shkresa të lëndës përkundër pretendimeve të paditësit, në padi dhe ankesë, rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta gjatë shqyrtimit të kësaj çështje në procedurë të konfliktit administrativ, nuk kanë gjetur fakte të cilat dëshmojnë që paditësi, eksportuesit i ka paguar çmimin real ashtu si e paraqet për mallin lëndor, prandaj kolegji vlerëson se, gjykatat e instancave më të ulëta drejtë kanë vlerësuar ligjshmërinë e vendimit përfundimtar të DK si në kuptim të nenit 9, 44 dhe 49 të LKA-së, kur gjejnë se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor doganor të paraqitur nga paditësi, nuk harmonizohen në kuptim të vlerës së mallit, për arsye se pagesa bankare në vlerën prej 46,866.47USD, e ka të përshkruar qëllimin e kësaj pagese vetëm në njëren faturë të mallit nr. KS....., ndërsa për faturën nr. KS20151018A, paditësi nuk ka paraqitur një pagesë tjetër bankare. Këtë mos harmonizim të dokumentacionit i njëjti nuk ka arritur ta sqaroj në gjykatë. Andaj nga një mos harmonizim i tillë gjykatat e pranojnë konstatimet si në vendimin e organit të paditur se paditësi nuk ka paraqitur dokumentacion të mjaftueshëm përcjellës të mallit lëndor të deklaruar për zhdoganim. Për deri sa si fakte vendimtare që kanë ndikuar për rivlerësimin e mallit sipas nenit 35 të KDA ka qenë se e paditura DK posedon të dhëna të disponueshme për mallin e njëjtë nga dosja e vlerës e cila është provë e bazuar për tu vlerësuar malli lëndor sipas kësaj metode të cilën e aprovon edhe gjykata dhe rivlerësimin e bërë sipas këtij nenin, sepse gjykatat në shqyrtim të kësaj lënde nga provat e ofruara nga paditësi nuk gjejnë fakte të bazuara që paditësi i ka paguar eksportuesit vlerën të cilën e deklaroi sipas faturave përcjellëse të mallit për tu bërë vlerësimi doganor sipas nenit 33 të KDA. Gjykatat po ashtu me të drejtë vendosin sipas gjendjes së vërtetuar edhe lidhur me kontestimin e shpenzimeve të transportit nga e paditura, për deri sa nga ky organ është vërtetuar drejtë, që paditësi nuk ka deklaruar drejtë dokumentacionin në kuptim të vlerës së shpenzimeve të transportit të cilat nuk përputhen me çmimet sipas U.A.../....., për përcaktimin e kostos së shpenzimeve të transportit. Nga kjo gjendje e vërtetuar në mungesat të dokumentacionit të kompletuar përcjellës të mallit lëndor si prove materiale, gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë vlerësojnë se vendimi i organit të paditur 07.3/147/2016, I dt. 18.07.2019 është i drejtë dhe ligjor, i bazuar në dispozitat ligjore dhe i arsyetuar mjaftueshëm

sipas gjendjes së vërtetuar, lidhur me rivlerësimin e mallit lëndor sipas metodës, VI, në kuptim të nenit 35 të KDA-së, në bazë të dhënave të disponueshme të DK-së, nga dosja e vlerës dhe zhdoganimeve të më hershme.

Pretendimet e paditësit të cekura si më lartë si dhe theksimet ndër të tjera në arsyetim të kërkesës se, gjykata e shkallës së dytë ka vepruar në kundërshtim me nenin 81 G, të Ligjit për Plotësimin e Ligjit për ATK sepse është dashtë të mbaj seancë të shqyrtimit publik ku palët dëgjohet dhe provat shqyrtohen për deri sa kjo gjykatë nuk ka caktuar seancë gjyqësore, kolegji i Gjykatës Supreme e refuzon si të pa bazuara dhe jo të qëndrueshme sepse sipas dispozitës së nenit 81 par. 1 pika 1.2 të Ligjit për plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit për ATK dhe proceduarat, është paraparë që lëndët të cilat zgjidhen sipas ankesës nga Bordi i Pavarur për Rishqyrtime,(BPR), kundër tyre pala ka mundur të ushtroj ankesë në Gjykatën Supreme deri me dt. 31.10.2012, dhe prej datës 1 nëntor 2012 në Gjykatën e Apelit. Kjo procedurë ka qen më afat të caktuar për deri sa të filloj që ankesat kundër vendimeve të shkallës së dytë të ATK dhe Doganave të Kosovës të shqyrtohen nga Divizioni Fiskal i Gjykatës Themelore i cili i ka marr kompetencat e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime, dhe është funksional duke filluar prej 01. 01. 2013 e tutje. Pra vetëm sa kanë qen në procedurë të vendosjes lëndët e vendosura nga ish BPR, si organ administrativ përfundimtar, kundër vendimeve të këtij organi ankesa(padia), është dorëzuar tek Gjykata e Apelit si shkallës së parë, e cila sipas nenit 81.G të ligjit të njëjtë ka qen e paraparë të mbajë seancë publike ku palët dëgjohen dhe provat shqyrtohen ashtu si e thekson pala ankuese, edhe pse Gjykata e Apelit sipas Ligjit për Gjykatat është shkallë e dytë e cila vendos në procedurë ankimore. Pas përfundimit të kësaj faze tranzitore bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Gjykatat dhe Ligjit për ATK dhe Procedurat 03/L222 dhe Ligjit për Plotësimet dhe ndryshimet e këtij ligji nr. 04/- 102, përkatësisht sipas neneve 81.A dhe B, Divizioni Fiskal duke filluar nga 01.01.2013, merr përgjegjësit e BPR dhe është organ i shkallës së parë në procedurë gjyqësore ku mund të dorëzohet një ankesë(padi) ndaj vendimeve të departamentit të ankesave në lidhje me taksat, detyrimet doganore, dhe si shkallë e parë mbanë seancë publike ku palët dëgjohen dhe provat shqyrtohen për deri sa sipas nenit 81.D, par. 1 pika 1.2, Gjykata e Apelit është gjykatë e shkallës së dytë e cila ka shqyrtuar vendimet gjyqësore të divizionit fiskal, i cili tani është funksional në kuadër të Gjatës Komerciale sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale nr.08/L-015.

Pretendimet e tjera se paditësi i ka bashkangjitur dokumentet e nevojshme me rastin e paraqitjes së mallit në doganë, duke e bashkangjitur faturën dhe pagesën bankare Dokumentit Unik Doganor në përputhje me neni 66 të KDA dhe nenit 123 të U A 11/2009, në bazë të cilave dëshmohet çmimi i paguar me qëllim të eksportit përkatësisht importit në Kosovë , andaj nuk janë të qëndrueshme konstatimet e gjykatave të instancave më të ulëta se për njërën pagesë nuk është paraqitur pagesën bankare, sepse paditësi ka bërë pagesën sipas kontratës në vlerë të përgjithshëm. Kolegji i Gjykatës Supreme, këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson po ashtu se nuk janë të bazuara dhe të qëndrueshme në fakte dhe prova të dëshmuara për vendosjen ndryshe të kësaj çështje, sepse nuk dëshmohet se aktgjykimi i Gjykatës Komerciale dhe ai i gjykatës së shkallës së parë që janë të përfshirë me shkeljet e pretenduara procedurale dhe materiale për deri sa në shkallë e parë dhe të dytë është vërtetuar në tërësi kjo çështje në bazë të provave të administruar

nga ka rezultuar se paditësi nuk ka disponuar me dokumentacion të kompletuar përcjellës të mallit të paraqitur për zhdoganim në kuptim të vlerës reale të mallit, për shkak të mos harmonizimit të pagesës bankare në vlerë prej 46,610.47USD e cila ka të përshkruar qëllimin e pagesës vetëm në një rën faturë të cekur si më lartë, për deri sa për faturën tjetër nuk ka disponuar me pagesë bankare. Këtë mos harmonizim të dokumenteve përcjellëse të mallit lëndor nuk ka arritur ta argumentoj apo sqaroj në as në procedurë gjyqësore, andaj me të drejtë nga këto fakte gjykatat e instancave më të ulëta e pranojnë mënyrën e vendosjes dhe arsyetimin si në vendimin e organit të paditur, të cilin e konfirmojnë si të drejtë dhe ligjor. Gjykatat e instancave më të ulëta me refuzimin e kërkesë padisë së paditësit kanë dhënë arsye të mjaftueshme, bindëse dhe të bazuara në ligj, lidhur me vërtetimin e fakteve me rëndësi vendimtare, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, nga rezulton se dokumentacioni i të paraqitur nga paditësi nuk ishte i mjaftueshëm dhe bindës për tu dëshmuar vlera reale e paguar, dhe për tu përcaktuar vlera doganore sipas metodës së parë, si parashihet me nenin 33, të KDA-së. Andaj me të drejtë nga DK, i është kontestuar vlera e deklaruar e mallit për zhdoganim, dhe duke u bazuar në vlerën reale të tij dhe në bazë të dhënave të disponueshme për mallin e njëjtë është bërë përcaktimi i çmimit lidhur me rivlerësimin e mallit lëndor sipas metodës, VI, në kuptim të nenit 35 të KDA-së, në bazë të dhënave të disponueshme të DK-së, nga zhdoganimet e tjera të më hershme dhe dosja e vlerës.

Mbi këtë gjendje të fakteve si më lartë rezulton se Gjykata Supreme nuk gjen prova dhe fakte se nga gjykatat e instancave më të ulëta janë bërë shkelje që do të ishin me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje, prandaj thënie e paditësit në kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pa bazuar. Aktgjykim i kontestuar me kërkesë është i qartë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykatat e instancave më të ulëta dhe organi administrativ përfundimtar i paditur, në këtë çështje juridike administrative drejtë kanë vërtetuar faktet vendimtare të çështjes lëndore dhe drejtë kanë aplikuar dispozitat ligjore të KDA-së, dhe LKA-së, andaj nuk është cenuar e drejta dhe ligji në dëm të paditësit.

Nga theksimet si më lartë, dhe në bazë të nenit 54, paragraf 1, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME – PRISHTINË
ARJ.nr. 24/2024, me datë 21 Mars 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani